



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 shtator 2023
Nr. ref.: MM 2251/23

MENDIM MOSPAJTUES

i gjyqtarit

RADOMIR LABAN

në

rastin nr. KO134/21

Parashtrues

Ramush Haradinaj dhe 9 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës
nr. 08-V-036, të 8 korrikut 2021**

Duke shprehur që në fillim respektin tim ndaj mendimit të shumicës së gjyqtarëve se në këtë rast, të cilët me shumicë votash konstatuan se Vendimi i Kuvendit nr. 08-V-036 nuk është në përputhshmëri me kërkesat e paragrafit 9, të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës.,

Megjithatë, Unë si gjyqtar individual kam mendim mospajtuës në lidhje me konkludimin e shumicës dhe nuk pajtohem me mendimin e shumicës. Konsideroj se gjykata ka qenë e detyruar t'i përgjigjet të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe t'i konstatoj të njëjtat t'i deklarjë në dispozitiv të aktgjykimit, sepse vetëm dispozitivi i aktgjykimit i detyron të gjithë personat fizikë dhe juridikë t'i respektojnë ato.

Si gjyqtar pajtohem me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në aktgjykim dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, unë si gjyqtar pajtohem me mënyrën se si janë parashtruar dhe paraqitur në aktgjykim pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe i pranoj të njëjtat si të sakta.

Megjithatë, nuk pajtohem me analizën ligjore lidhur me pranueshmërinë e rastit në një pjesë dhe qëndrimin e shumicës në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Për sa më sipër, dhe në pajtim me rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, dhe për të ndjekur sa më lehtë dhe qartë arsyetimin e mendimit tim mospajtues, Unë do **(I)** të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë në lidhje me mospërputhjen e aktit të kontestuar me nenet 4, 7.1 dhe 65.9 të Kushtetutës; **(II)** të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimet për shkelje të të drejtave individuale nga Kapitulli II i Kushtetutës, përkatësisht nenet 24, 31, 32, 45 dhe 54 të Kushtetutës; **(III)** të shpreh mendimin lidhur me kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme; **(IV)** të paraqes një përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave], si dhe nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], të Kushtetutës.

(I) Vlerësimi i kushtetutshmërisë lidhur me mospërputhjen e aktit të kontestuar me nenet 4, 7.1 dhe 65.9 të Kushtetutës

1. Fillimisht i referohem pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me mospërputhjen e aktit të kontestuar me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] në lidhje me nenin 7 [Vlerat] dhe 65.9 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës.

i. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 4 në lidhje me nenin 7.1 të Kushtetutës

2. Rikujtoj përmbajtjen e nenit 4, paragrafët 1, 2, 3 dhe 5 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7.1 [Vlerat] e Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.

[...]

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.

[...]

4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

Neni 7

[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

[...]

3. Lidhur me këto pretendime, rikujtoj pjesët përkatëse të parimeve të përgjithshme në lidhje me parimin e ndarjes së pushteteve të vendosura nga praktika e Gjykatës, si në rastin KO219/19, në të cilin u theksua se parimi i sigurisë juridike dhe

parashikueshmërisë janë karakteristika thelbësore të ligjit dhe pjesë përbërëse e parimit kushtetues të sundimit të ligjit. Siguria juridike është një nga shtyllat kryesore të sundimit të ligjit dhe kërkon, ndër të tjera, që rregullat të jenë të qarta dhe të sakta dhe të përpiqen të sigurojnë që situatat juridike dhe marrëdhëniet të mbeten të parashikueshme. Parashikueshmëria para së gjithash kërkon që norma juridike të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme, në mënyrë që t'u mundësohet individëve dhe personave juridikë të rregullojnë sjelljen e tyre në përputhje me të. Individët dhe personat e tjerë juridikë duhet të dinë saktësisht se si dhe në çfarë mase preken nga një normë e caktuar juridike dhe si një normë e re juridike ndryshon statusin ose gjendjen e tyre të mëparshme të parashikuar nga një normë tjetër juridike. Organet publike gjatë hartimit të ligjeve duhet t'i kenë parasysh edhe këto parime themelore të sundimit të ligjit, si pjesë e rëndësishme e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.

4. Lidhur me këtë pretendim, rikujtoj se shkeljen e nenit 4 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës e lidhin me mënyrën e shkarkimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së, me arsyetimin se një shkarkim i tillë *"... nuk mund të jetë prerogativë e mbikëqyrjes, i cili e përbën një veprim ekzekutiv, që bie ndesh me fuzionominë kushtetuese të Kuvendit, si organ ligjvënës"*. Prandaj, sipas pretendimeve të tyre, kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve nga neni 4, i cili në të njëjtën kohë paraqet vlerë kushtetuese në kuptim të nenit 7.1 të Kushtetutës.
5. Në këtë kontekst, fillimisht rikujtoj se iniciativa për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së ka ardhur në Kuvend nga komisionet funksionale parlamentare dhe nga ai moment Kuvendi, bazuar në nenin 65.9 të Kushtetutës, nenin 28 të Ligjit për RTK-në dhe nenin 67 të Rregullores së punës të Kuvendit, dhe për të cilën iniciativë më pas u zhvillua debat parlamentar, pas së cilës u votua me votim të posaçëm për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në pritje të miratimit të aktit të kontestuar nga Kuvendi. Prandaj, ky pretendim do të shqyrtohet në kuadër të paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, sepse parashtruesit e kërkesës ngrenë pikëpyetje për përmbajtjen dhe procedurën e zhvilluar.
6. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se edhe me rastin e shkarkimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së është shkelur parimi i sigurisë juridike, gjegjësisht parimi i parashikueshmërisë, sepse as Ligji për RTK-në dhe as ndonjë ligj tjetër nuk e parasheh dhe nuk e lejon shkarkimin e të gjithëve anëtarëve të Bordit të RTK-së menjëherë. Në këtë kuptim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se një procedurë e tillë e paparashikuar me ligj, shkel të gjitha parimet procedurale të përcaktuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në raport me anëtarët e Bordit të RTK-së.
7. Në këtë kontekst, ju rikujtoj se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për mangësitë e Ligjit për RTK-në dhe ligjeve tjera, ngre çështjen e mospërputhjes së tyre me Kushtetutën. Megjithatë, sa i përket Ligjit për RTK-në, rikujtoj se Kuvendi e ka miratuar këtë ligj më 29 mars 2013 dhe se palët e autorizuara asnjëherë nuk e kanë kontestuar kushtetutshmërinë e tij në Gjykatë. Rrjedhimisht, një pretendim i tillë duhet të deklarohet i papranueshëm sepse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës. Megjithatë, theksoj se Kushtetuta, përveç mundësisë për të kontestuar kushtetutshmërinë e një ligji apo norme në Gjykatë, rikujton se Kushtetuta ka përcaktuar modalitete të tjera për mundësinë e kontestimit të kushtetutshmërisë së një norme të caktuar të ligjit, dhe që përmes kontrollit konkret (incidental), sipas paragrafit 8, nenit 113 të Kushtetutës. Anëtarët e Bordit të RTK-së duket se e kanë humbur këtë mundësi kushtetuese, pasi nuk iu drejtuan gjykatave të rregullta për ta shfrytëzuar një mundësi të tillë.

8. Përveç kësaj, asnjë argument tjetër për shkeljen e nenit 4 të Kushtetutës nuk mbështet pretendimin e parashtruesve të kërkesës se ligji i kontestuar i Kuvendit është miratuar në kundërshtim me këtë të drejtë themelore nga Kushtetuta.

ii. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 65.9 të Kushtetutës

9. Lidhur me këtë, rikujtoj se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se akti i kontestuar është në kundërshtim me nenin 65.9 të Kushtetutës për shkak të ushtrimit arbitrar të kompetencës së Kuvendit për mbikëqyrjen e punës së institucioneve publike, gjë që cenon të drejtat e anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së që rrjedhin nga Kapitulli II i Kushtetutës, si dhe dokumentet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës, janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
10. Në këtë kuptim, vërej se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkeljen e nenit 65.9 të Kushtetutës lidhet kryesisht me ushtrimin arbitrar të kompetencës së Kuvendit në mbikëqyrjen e institucioneve publike, në këtë rast të Bordit të RTK-së, i cili, sipas tyre, ka ndodhur si pasojë e shkeljes së nenit 28 të Ligjit për RTK-në.
11. Në këtë kontekst, i referohem përmbajtjes së nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, paragrafi 5, i cili shprehimisht thekson se “Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”
12. Rrjedhimisht, në vijim do të analizoj procedurën e zhvilluar nga Kuvendi deri në miratimin e aktit të kontestuar dhe përmbajtjen e aktit të kontestuar, për të arritur në një përfundim objektiv nëse ka mospërputhje ndërmjet këtyre dy aspekteve me nenin 65.9 të Kushtetutës.

a) Lidhur me procedurën e zhvilluar

13. Në lidhje me procedurën e zhvilluar nga Kuvendi deri në miratimin e aktit të kontestuar, i referohem shkresave të lëndës të dorëzuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe vërej se është dorëzuar propozimi për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së. nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, i cili është miratuar nga Kuvendi më 22 qershor 2021, dhe i cili ndër të tjera përmban arsyet në të cilat bazohet një propozim i tillë (shih paragrafin 18 të këtij dokumenti).
14. Kjo e drejtë e Komisionit përkatës rrjedh nga neni 28, paragrafi 2.1 i Ligjit për RTK-në, i cili parasheh.

Neni 28

[Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit]

(...)

2.1. propozimi për shkarkim vie nga Bordi i RTK-së me kërkesën e shumicës së thjeshtë të numrit të anëtarëve të Bordit ose të ndonjë iniciative tjetër nga jashtë sipas kushteve të përcaktuara nga paragrafi 3 i këtij neni

15. Më tej, vërej se Kuvendi, më 7 korrik 2021, i njoftoi deputetët për mbajtjen e seancës së radhës plenare, ku një nga pikat e rendit të ditës ishte shqyrtimi i rekomandimit nr.

08/358/Do-238 të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

16. Vërej se pas një diskutimi shterues parlamentar të mbajtur në Kuvend më 7 korrik 2021 në lidhje me pikën pesë (5) të rendit të ditës (shqyrtimi i rekomandimit nr. 08/358/Do-238 i Komisionit të lartpërmendur), rezulton se votimi për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së është bërë për secilin anëtar individualisht, si në vijim:
- shkarkimi i anëtarit Sali Bashota: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim;
 - shkarkimi i anëtarit Agron Gashi: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim;
 - shkarkimi i anëtarit Lirim Geci: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim;
 - shkarkimi i anëtarit Ilir Bytyqi: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim;
 - shkarkimi i anëtarit Albinot Maloku: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim;
 - shkarkimi i anëtarit Bajram Mjeku: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim;
 - shkarkimi i anëtarit Petrit Musolli: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim; dhe
 - shkarkimi i anëtarit Fadil Miftari: 64 vota për, 0 vota kundër dhe 1 abstenim..
17. Pas përfundimit të procesit të votimit, Kuvendi, më 8 korrik 2021, miratoi aktin e kontestuar nr. 08-V-036, me të cilin zyrtarisht konfirmohet shkarkimi i 8 (tetë) anëtarëve të Bordit të RTK-së. Sipas procesverbalit, deputeti Bekim Haxhiu ka kundërshtuar mënyrën e votimit, i cili është këshilluar nga kryetari i Kuvendit që të përdorë instrumentet ligjore në dispozicion për shkak të shkeljeve të mundshme të procedurës së votimit.
18. Në këtë kontekst, rikujtoj se parashtruesit e kërkesës e lidhin pretendimin e tyre me faktin se shkarkimi i anëtarëve të Bordit është bërë në mënyrë “bllok” dhe kolektive. Mirëpo, sipas shkresave të lëndës, një pretendim i tillë nuk qëndron sepse procedura e votimit është bërë për secilin anëtar të Bordit të RTK-së individualisht dhe pas mbylljes së votimit, Kryetari i Kuvendit ka konstatuar shkarkimin e secilit anëtar përkatës. Fakti që të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së kanë marrë numër identik të votave për, kundër dhe abstenim, nuk do të thotë se shkarkimi i tyre është bërë në grup dhe në kundërshtim me procedurat e përcaktuara kushtetuese dhe ligjore.
19. Krahas kësaj, parashtruesit e kërkesës deklarojnë se shkelja e nenit 65.9 të Kushtetutës ka ndodhur edhe si rezultat i ushtrimit arbitrar të kompetencës nga ana e Kuvendit për shkak se shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së është bërë në kundërshtim me Ligjin për RTK-në.
20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet përmbajtjes së paragrafit 2.2 të nenit 28 të Ligjit për RTK-në dhe vëren se ai përcakton si në vijim:

Neni 28

[Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit]

(...)

“2.2 Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të Bordit”.

21. Kjo dispozitë e ligjit përmend një anëtar të Bordit, në njëjës, por nuk do të thotë se Kuvendi kufizohet të votojë vetëm për shkarkimin e një anëtarit ose disa anëtarëve të Bordit. Gjithashtu, Gjykata rikujton se kuptimi dhe qëllimi i dispozitës duhet të lexohet në kontekst, sepse nëse i referohemi kuptimit të fjalës “Bord” që nënkupton një “trup” të përbërë nga disa individë, kjo nuk do të thotë se përgjegjësia për

mospërmbushjen e qëllimit për të cilin është krijuar "Bordi" duhet të jetë individuale dhe të bjerë mbi barrën e vetëm një ose dy anëtarëve të të njëjtit.

22. Në këtë kontekst, është e qartë se rekomandimi i komisionit funksional parlamentar e bën Bordin përgjegjës në tërësi dhe nuk i referohet një numri të caktuar anëtarësh. Megjithatë, është në diskrecionin e plotë të shumicës së thjeshtë të Kuvendit që të vendosë me vota: për, *kundër ose me abstenim* për shkarkimin ose jo të çdo anëtar të Bordit, duke konfirmuar kështu besimin e mandatit të tyre.
23. Prandaj, nga sa më sipër, rezulton se procedura e zhvilluar deri në miratimin e aktit të kontestuar bazohet në Kushtetutë dhe ligj dhe se si e tillë është në përputhje me kërkesat e nenit 65.9 të Kushtetutës, si dhe me dispozitat e lartpërmendura nga neni 28 i Ligjit për RTK-në.

b) Sa i përket aspektit përmbajtjesor

24. Sa i përket aspektit përmbajtjesor, rikujtoj se parashtruesit e kërkesës deklarojnë se akti i kontestuar është në kundërshtim me paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, për shkak të ushtrimit arbitrar të kompetencës së Kuvendit për mbikëqyrjen e punës së institucioneve publike dhe se, për rrjedhojë, me aktin e kontestuar janë shkelur të drejtat e anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së, të cilat rrjedhin nga Kapitulli II i Kushtetutës, si dhe dokumentet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës, janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.
25. Parashtruesit e kërkesës më tutje theksojnë se fakti se akti i kontestuar nuk i përmend arsyet nga neni 28 i Ligjit për RTK-në për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së nënkupton se Kuvendi e ka ushtruar autoritetin e tij kushtetues të përcaktuar me nenin 65.9 të Kushtetutës. arbitrarisht dhe përtej kushteve të përcaktuara me nenin 28 të Ligjit për RTK-në. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së nuk mund të jetë prerogativë e mbikëqyrjes, e cila paraqet veprim ekzekutiv, i cili është në kundërshtim me fizionominë kushtetuese të Kuvendit, si organ ligjvënës.
26. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se akti i kontestuar "*nuk i përmend arsyet nga neni 28 i Ligjit për RTK-në*", vlerësoj se arsyet për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së janë dhënë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar nga komisioni kompetent parlamentar. Unë kam konstatuar se në bazë të gjetjeve dhe propozimeve të komisionit në fjalë, Kuvendi hapi një diskutim parlamentar, për t'i dhënë mundësi secilit deputet që, përpara se të vazhdojë me votimin, të shprehë qëndrimet dhe kundërshtimet e tij, në lidhje me propozimin për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, dhe nëse një propozim i tillë ka qenë objektivisht i arsyetuar dhe i bazuar, për të votuar *për, kundër ose abstenim*.
27. Po ashtu rikujtoj se përfaqësuesit e Bordit të RTK-së dhe anëtarët e tij ishin ftuar rregullisht për t'u dëgjuar para komisionit përkatës parlamentar, në mënyrë që ata të mund të shprehin kundërshtimet e tyre ndaj gjetjeve të komisionit lidhur me mospërmbushjen e detyrave dhe qëllimit për të cilin u krijua bordi.
28. Në dritën e rrethanave të rastit konkret, vërej se akti i kontestuar i Kuvendit, në fakt, përmban bazën ligjore mbi të cilën është miratuar; emrat e tetë (8) anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së dhe datën e hyrjes në fuqi të tij. Për më tepër, paragrafi 9 i nenit 65 të Kushtetutës, i cili pretendohet se është shkelur nga shumica në Kuvend, nuk përcakton se si duhet të duket forma dhe përmbajtja e aktit parlamentar, apo më qartë nëse akti (vendimi) i Kuvendit duhet të përmbajë arsye për shprehjen e vullnetit të deputetëve me votim të lirë. Po ashtu, rikujtoj se përmbajtja e aktit të kontestuar

konfirmon dhe legjitimon arsyetimin e komisionit përkatës parlamentar, si dhe propozimin e tij për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

29. Prandaj, pretendimet e parashtruesve të kërkesës se akti i kontestuar nuk përmban arsyetim për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në vetvete nuk paraqet pretendim të argumentuar për shkeljen e aspekteve përmbajtjesore të nenit 65.9 të Kushtetutës, sepse arsyet e shkarkimit të anëtarëve të bordit të përmendur tashmë ishin të njohura nga gjetjet e komisionit dhe i ishin paraqitur në mënyrë të duhur Kuvendit, në përputhje me dispozitat në fuqi.

30. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së nuk mund të jetë prerogativë e mbikëqyrjes, që paraqet veprim ekzekutiv, i cili është në kundërshtim me fizionominë kushtetuese të Kuvendit, si organ ligjvënës, i referohem përmbajtjes së paragrafit (9) të nenit 65 të Kushtetutës, i cili përcakton se Kuvendi:

“9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit”.

31. Për sa i përket fjalisë *“institucionet e tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe ligjit i raportojnë Kuvendit”*, i referohem nenit 30 [Veprimtaria dhe mënyra e punës së Bordit të RTK-së], paragrafi 8 i Ligjit për RTK, i cili përcakton:

“8. Bordi i RTK-së sipas këtij ligji është i detyruar që për punën e vet të raportoj, themeluesit të tij, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme”.

32. Për më tepër, për të përcaktuar *“themeluesin e RTK-së”* në kuptim të paragrafit 8 të nenit 30 të Ligjit për RTK-në, i referohem nenit 4 [Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës] të Ligjit për RTK-në, i cili parasheh:

“1. Kuvendi i Republikës së Kosovës është themelues i Radiotelevizionit të Kosovës”.

33. Prandaj, nga kuptimi i dispozitave të nenit 30 (8) dhe 4 (1) të Ligjit për RTK-në, është e qartë se Bordi i RTK-së për punën e tij i raporton themeluesit, përkatësisht Kuvendit. Në këtë kontekst, nuk kontestohet se Bordi i RTK-së për punën e tij duhet t'i raportojë Kuvendit, i cili në këtë rast e mbikëqyr punën e tij në kuptim të paragrafit (9) të nenit 65 të Kushtetutës. Situata do të ishte ndryshe nëse Ligji për RTK-në do të përcaktonte që Bordi i RTK-së i raporton Qeverisë për punën e tij, por nuk është kështu.

34. Prandaj, në dritën e rrethanave të këtij rasti, nuk bëhet fjalë për tejkalim të kompetencës së Kuvendit dhe as për ndërhyrje të tij në domenin e Qeverisë. Kjo vërteton se pretendimi i parashtruesve të kërkesës se Kuvendi ka vepruar në kundërshtim me paragrafin (9) të nenit 65 të Kushtetutës dhe se kryerja e veprimtarive të Kuvendit është në kundërshtim me rolin e Kuvendit, sipas nenit 65 (9) të Kushtetutës, është e pabazuar.

35. Rrjedhimisht, konsideroj se përmbajtja e aktit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 65 (9) të Kushtetutës.

(II) Vlerësimi i kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimet për shkelje të të drejtave individuale nga Kapitulli II i Kushtetutës, përkatësisht nenet 24, 31, 32, 45 dhe 54 të Kushtetutës.

36. Më tej, gjatë vlerësimit të pranueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës se me aktin e kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të anëtarëve të Bordit të RTK-së nga Kapitulli II i Kushtetutës, do të vlerësoj thelbin e pretendimeve të bëra për secilin prej neneve përkatëse të Kushtetutës.

Lidhur me shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës

37. Vërej se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit lidhet me 1) procedurat e mbledhjeve të mëparshme të Kuvendit, me argumentin se Kuvendi nuk kishte shkarkuar asnjëherë më parë anëtarët e bordit para skadimit të mandatit të tyre trevjeçar, i cili i sjell anëtarët e shkarkuar të Bordit të RTK-së në pozitë të pabarabartë në raport me ish anëtarët e bordeve të mëparshme dhe 2) trajtim jo i barabartë i vetë anëtarëve të Bordit të RTK-së, për faktin se Kuvendi nuk ka bërë dallim ndërmjet tre (3) anëtarëve të Bordit të RTK-së të cilët kanë shërbyer pothuajse një mandat të plotë në krahasim me pesë (5) anëtarët e tjerë të Bordit që kanë qenë në detyrë për më pak se një vit nga emërimi i tyre.

Lidhur me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës

38. Vërej se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm lidhet me shkeljen e të drejtës për t'u dëgjuar të anëtarëve të Bordit të RTK-së nga Kuvendi dhe pamundësinë për të paraqitur kundër-argumentet në lidhje me faktet dhe çështjet.

Lidhur me shkeljen e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës

39. Vërej se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e këtyre neneve të Kushtetutës lidhet me faktin se Ligji për RTK-në nuk parasheh mjete juridike efektive që mund të përdoren kundër akteve të Kuvendit që kanë të bëjnë me shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kjo nuk është e mundur as përmes një procedure të rregullt administrative.

Lidhur me shkeljen e nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës

40. Vërej se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljen e kësaj të drejte kushtetuese bazohet në argumentin se anëtarët e Bordit të RTK-së nuk pranohen në kushte të përgjithshme të barazisë për ushtrimin e funksioneve të tyre për shkak se shkarkimi i tyre është ndërmarrë jashtë kushteve të përcaktuara me Ligjin për RTK-në, përkatësisht nenin 28, të cilin vendimi i kontestuar e merr për bazë, duke mos ofruar kushte të barabarta, krahasuar me mënyrën se si Kuvendi ka vepruar ndaj anëtarëve të Bordit të RTK-së, nga themelimi i tij e deri më tani, përkatësisht gjatë kohës kur ishte në fuqi Ligji i vlefshëm për RTK-në.

Analiza e pranueshmërisë në lidhje me nenet përkatëse

41. Për sa i përket kushteve për vlerësimin e kushtetutshmërisë së “ligjit” të miratuar nga Kuvendi dhe “vendimit” të miratuar nga Kuvendi, në kuptim të nenit 113.5, ai thekson se kontestimi i kushtetutshmërisë së një ligji është dukshëm i ndryshëm nga kontestimi i kushtetutshmërisë së një vendimi. Ky dallim konsiston në faktin se çfarë përcakton përmbajtjen e aktit, pra cilat janë pasojat juridike që prodhon akti i Kuvendit, përkatësisht nëse përmbajtja e normës së shkruar të aktit të Kuvendit ka efekt *erga omnes* apo ka një efekt në një subjekt të caktuar (individ).
42. Prandaj, konsideroj se ajo që Gjykata duhet të vlerësojë në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut nga Kapitulli II i Kushtetutës është çështja se çfarë pasojash juridike prodhoi akti i kontestuar i Kuvendit në dritën e rrethanave të rastit konkret, me qëllim që të vlerësohet më tej nëse pretendimet e tilla të parashtruesve të kërkesës ngritën çështje kushtetuese nga neni 113.5 i Kushtetutës dhe nëse parashtruesit e kërkesës legjitimojnë veten si palë të autorizuarra për të ngritur pretendime të tilla.
43. Në këtë kontekst i referohem edhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Vendimit nr. 29/09, të 21 tetorit 2009, me parashtrues: *Grupi prej 30 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet të cilit, ndër të tjera, kërkohej anulimi i Vendimit të Kuvendit [Nr. 190] të 16 qershorit 2008, për shkak të mosdhënies së pëlqimit për emërimin e z. Z.P, për anëtar të Gjykatës Supreme. Për përcaktimin e kompetencës së saj, gjykata vlerësoi nëse objekti i kontrollit kushtetues përpara saj është një akt me karakter normativ dhe nëse synimet e tij ngrenë çështje konflikti kompetencash ndërmjet autoriteteve qendrore apo lokale. Në dritën e rrethanave të çështjes, gjykata në fjalë konstatoi: „Gjykata është shprehur më parë se në gjykimet e natyrës abstrakte nuk është kompetente të kontrollojë akte të karakterit individual. Duke qenë se vendimi i Kuvendit, i cili është objekt shqyrtimi, pasqyron vullnetin e Kuvendit për të mos dhënë pëlqimin për emërimin e një anëtari të Gjykatës Supreme, Gjykata pranon se ky akt ka karakter individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk është kompetente të kontrollojë vendimin e Kuvendit nr. 190, të 16.06.2008. Në përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa e ngritur nga një grup prej të paktën një të pestës së deputetëve (1/5) i referohej anulimit të vendimit të Kuvendit nr. 190, të 16.06.2008. duhet shfuqizuar për shkak të **mungesës së legjitimitetit të parashtruesve të kërkesës dhe mungesës së juridiksionit të kësaj gjykate.***
44. Vërej se pretendimet e parashtruesve të kërkesës se me aktin e kontestuar të Kuvendit janë shkelur të drejtat kushtetuese të anëtarëve të Bordit të RTK-së, të cilat garantohen me nenet 24, 31, 32, 45 dhe 54 të Kushtetutës, ngrenë çështje kushtetuese, por jo nga paragrafi 5 i nenit 113 të Kushtetutës, në rrethanat e rastit konkret sepse akti i kontestuar cilësohet si akt juridik i karakterit individual dhe cenon vetëm të drejtat individuale të anëtarëve të Bordit të RTK-së në veçanti.
45. Prandaj, besoj se anëtarët e shkarkuar të Bordit të RTK-së, në rrethana të tilla, janë viktima të mundshme të shkeljes së të drejtave të tyre individuale me aktin e kontestuar. Prandaj, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara të Kushtetutës], të cilët përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

46. Në vlerësimin e kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 113 të Kushtetutës, vlerësoj se parashtruesit e kërkesës nuk legjitimohen si palë e autorizuar për të ngritur çështje të shkeljes së të drejtave individuale të anëtarëve të Bordit të RTK-së, të garantuara me nenet 24, 31, 32, 45 dhe 54 të Kushtetutës, nëpërmjet kontrollit abstrakt parandalues, i cili bie në fushën e nenit 113.5 të Kushtetutës.
47. Në vijim, rikujtoj se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se anëtarëve të Bordit të RTK-së iu janë shkelur të drejtat individuale për shkak se Ligji për RTK-në nuk **parasheh mjete juridike efektive** kundër aktit të kontestuar të Kuvendit. Megjithatë, vlerësoj se kjo nuk duhet kuptuar apriori se anëtarët e Bordit të RTK-së janë të përjashtuar si kategori juridike nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike efektive në procedurat e rregullta kundër aktit të kontestuar të Kuvendit, sepse kjo prek drejtpërdrejt të drejtat e tyre kushtetuese.
48. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës kanë ngritur pretendime për shkelje të të drejtave individuale të anëtarëve të Bordit të RTK-së, vetëm në bazë të argumentit se Ligji për RTK-në "*nuk parasheh mjete juridike*", se kundër aktit të kontestuar kërkohet mbrojtje juridike e të drejtave pranë gjykatave të rregullta.
49. Në këtë kuptim, bazuar në normat kushtetuese, në praktikën time, dhe duke iu referuar parimeve të vendosura nga GJEDNJ, rikujtoj se legjislacioni ynë nuk parasheh shprehimisht përjashtimin e kësaj kategorie individësh që ushtrojnë funksione publike, për të mos kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre në gjykatat e rregullta. Për më tepër, e drejta e tyre për qasje efektive në drejtësi buron nga Kushtetuta, edhe nëse një gjë të tillë shprehimisht nuk e përcakton Ligji për RTK-në (shih, në mënyrë analoge, GJEDNJ, rastin [*Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*](#), nr. 63235/00, Aktgjykimi i 19 prillit 2007, paragrafi 62, dhe rastin e Gjykatës KI214/21, me parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykimi 7 dhjetorit 2022, paragrafi 125).
50. Po ashtu rikujtoj se Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative ofron mjete juridike efektive për zgjidhjen e rastit të kësaj kategorie funksionarësh publik. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se vet qëllimi i LKA-së si ligj, siç përcaktohet në nenin 2 [Qëllimi] është të sigurojë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë dhe palëve të tjera, të cilëve u janë shkelur të drejtat dhe interesat me: (i) aktet individuale; ose (ii) veprimet e organeve të administratës publike. Me nenin 3, paragrafi 1.1 i LKA-së përcaktohet se organet e administratës publike janë organe të administratës qendrore, ndërsa paragrafi 1.2 i të njëjtit nen cilëson si akt administrativ çdo vendim të organit administrativ të nxjerrë pas procedurës administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose tërthorazi cenon të drejtat, liritë apo interesat e personave fizikë dhe juridikë të njohura ligjërisht. Përveç, dispozitës me të cilën përcaktohet qëllimi i ligjit, më konkretisht, neni 10 i LKA-së, ndër të tjera, parashikon mundësinë e fillimit të një konflikti administrativ kundër akteve për të cilat një person fizik ose juridik konsideron se është shkelur një e drejtë ose interes ligjor (shih, KI214/21, cituar me lart, paragrafi 115 dhe 116).
51. Do të konsiderohej heqje dorë nga e drejta e tyre kushtetuese nëse anëtarët e Bordit të RTK-së do t'ia linin të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në gjykatë në mëshirë dhe vullnet të parashtruesve të kërkesës, ku praktika gjyqësore e Gjykatës dhe GJEDNJ-së saktësojnë se „*çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim specifik para një gjykate, mund*

t'i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për "qasje në drejtësi" (shih, KI214/21, cituar më lart, paragrafi 107). Lidhur me këtë, askush nuk i pengoi anëtarët e bordit të RTK-së që të kërkojnë qasje në gjykatën civile kompetente për zgjidhjen e kontestit të tyre, i cili ekskluzivisht bie në fushën e marrëdhënieve të punës, duke iu referuar nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së.

52. Prandaj, konsideroj se pretendimi i parashtruesve të kërkesës se anëtarëve të Bordit të RTK-së, Ligji për RTK-në nuk u jep mjete efektive për të ushtruar të drejtat e tyre civile, nuk qëndron dhe nuk arsyetohet objektivisht, sepse asnjë dispozitë ligjore apo kushtetuese nuk ua ndalon anëtarëve të Bordit të RTK-së të drejtën për të kërkuar mbrojtjen ligjore të të drejtave të tyre në procedurë të rregullt, siç përcaktohet me nenin 54 të Kushtetutës.
53. Prandaj, bazuar në sa më sipër, konsideroj se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar, në lidhje me të drejtat e njeriut të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, si dhe anëtarët e Bordit të RTK-së nuk mund të lirohen nga detyrimi kushtetues për të shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të parashikuara me ligjet në fuqi në procedurë të rregullt, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës.
54. Në këtë mënyrë, konsideroj se kërkesa e parashtruesve në lidhje me shkeljet e të drejtave individuale të anëtarëve të Bordit të RTK-së, të garantuara me nenet: 24, 31, 32, 45 dhe Kushtetutës, nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim të mëtejshëm të meritave të kërkesës.

(III) Kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme

55. Për sa i përket kërkesës së tyre për nevojën e vendosjes së masës së përkohshme, parashtruesit e kërkesës e bazuan pretendimin e tyre në nenin 27 të Ligjit, me argumentin se e njëjta është e nevojshme për të eliminuar rrezikun apo dëmet e pariparueshme dhe se vendosja e kësaj mase të përkohshme është në interesin publik.
56. Mirëpo, rikujtoj se i konsideroj të papranueshme pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, në pjesën që ka të bëjë me të drejtat kushtetuese të anëtarëve të Bordit të RTK-së nga Kapitulli II i Kushtetutës, dhe se kërkesa e parashtruesve lidhur me pretendimin për mospërputhjen e aktit të kontestuar me nenet 4, 7 dhe 65.9 të Kushtetutës, për mendimin tim, nuk ka rezultuar me shkelje të neneve përkatëse. Nisur nga sa më sipër, nuk e konsideroj të nevojshme të shqyrtojë në mënyrë specifike pretendimet e parashtruesve në lidhje me vendosjen masës së përkohshme.
57. Rrjedhimisht, pajtohem që kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme duhet të refuzohet, në pajtim me nenin 27 të Ligjit.

(IV) Përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesve të kërkesës

58. Bazuar në sa më sipër, dhe duke marrë parasysh edhe shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në kërkesën e tyre:

- I. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme për shqyrtim meritore të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, lidhur me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], në lidhje me nenin 7 [Vlerat] dhe 65.9 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës;
- II. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur TË KONSTATOJË, se me Vendimin e Kuvendit nr. 08-V-036, nuk janë shkelur nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat] dhe 65.9 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës;
- III. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme për shqyrtim meritore të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkeje të të drejtave kushtetuese të anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës, të garantuara me nenet: 24.1 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.
- IV. PAJTOHEM me konkluzionin e Gjykatës që TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesve për vendosjen e masës së përkohshme.

Mendimi mospajtuës është paraqitur nga gjyqtari;

Radomir Laban, gjyqtar



Më 02 gusht 2023 në Prishtinë

